

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Lumine Dent” shpk**

- 1) Sot, më 26/12/2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Lumine Dent” shpk.**
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:
Z. Enejd Saliaj, atësia Pëllumb, shtetas Shqiptar, identifikuar me ID me nr. J50902111D, I datëlindjes 02/09/1995 lindur në Ballsh dhe banues në Tiranë, Rr. 3 Dëshmorët, Kompleksi Grand Gallery, Yzberisht, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtme.

**Neni 1
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është **“Lumine Dent” shpk.**
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

Shoqëria ka për objekt kryesor aktivitetin në fushën e turizmit dentar, duke ofruar shërbime dentare të avancuara dhe të cilësisë së lartë për klientët vendas dhe të huaj. Aktivitetet përfshijnë konsultat dhe trajtimet dentare si karieset, trajtimi i rrënjëve, vendosja e implanteve, ortodoncia dhe estetikën dentare.

Gjithashtu, shoqëria do të ofrojë paketat turistike për pacientët ndërkombëtarë, duke përfshirë shërbime akomodimi, transporti dhe asistencë për të lehtësuar trajtimet dentare jashtë vendit të tyre. Shoqëria do të angazhohet në promovimin e shërbimeve të saj përmes kanaleve të ndryshme marketingu, duke përfshirë media sociale dhe aktivitete ndërkombëtare.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr. 5, Rruga Andon Zako Cajupi, Ndërtesa 3, Hyrja Nr. 11, Kati 2, Ap. No. 2
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 (Dhjetë mijë) Lekë dhe është i përbërë nga 1 (një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
A. Ortakët themelues:



- **Z. Enejd Saliaj**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 (Dhjetë mijë) Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6

Organi Vendimmarrës

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj

Neni 7

Administratori

1) Administratorë të shoqërisë emërohet :

- **Z. Enejd Saliaj**, atësia Pëllumb, shtetas Shqiptar, identifikuar me ID me nr. J50902111D, I datëlindjes 02/09/1995 lindur në Ballsh dhe banues në Tiranë, Rr. 3 Dëshmorët, Kompleksi Grand Gallery, Yzberisht, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 8

Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimit dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimit, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

Neni 9

Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.
- 2)

ORTAKET E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Lumine Dent" shpk

Z. Enejd Saliaj

